



**REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVO**  
**KUVENDI I KOMUNES - SKUPŠTINA OPŠTINE**  
**DRAGASH - DRAGAŠ**  
**ZYRA PËR PROKURIM – KANCELARIJA ZA JAVNU NABAVKU**

Zyra per prokurim ne Dragash, ne baze te **kerkeses per rishqyrtim** te bere me date **12.04.2021** nga **OE " BS2"Sh.p.k -Gjakove** , ne lidhje me aktivitetin e Prokurimit me nr: 621-21-1162-121 ", dhe nr, te mbrendshem 621-2021-007-121," **Blerja e Autoambulancave ne Q.K.M.F-Dragash** " duke u bazuar ne Rregullat qe adoptojne, plotesojne dhe japin sqarime per paraqitje te kerkeses per rishqyrtim prane Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim te ankesave prane OSHP-se dhe vlera e tarifave te ankesave si dhe duke u bazuar ne nenin 8.1.1 te kesaj rregulloreje-te aprovuara nga Komisioni Rregullativ I Prokurimit Publik I cili ne pajtim me Nenin 87,paragrafi 2,nen paragrafin 2.8 dhe nenin 118,paragrafi 1,te Ligjit mbi prokurimin Publik nr.04/L-042,I ndryshuar dhe plotesuar me ligjin nr.04/L-237,ligjin nr.05/L-068 dhe ligjin nr.05/L-092,dhe nenit 39.8 te RRUOPP-it bjen kete :

## **V E N D I M**

**Refuzohet kerkeses per rishqyrtim e OE " BS2 "Sh.p.k -Gjakove e propozuar per rishqyrtim si e pa baze**

## **A R S Y E T I M**

Lidhur me kerkesen tuaj per rishqyrtim te vendimit, Autoriteti Kontraktues konstaton se pretendimet tuaja ne lidhje me aktivitetin e prokurimit me nr: 621-21-1162-121 ", dhe nr, te mbrendshem 621-2021-007-121," Blerja e Autoambulancave ne Q.K.M.F-Dragash "jane te pa bazuar per faktin se:

Se pari ne lidhje me pretendimet tuaja se nuk ju kemi ofruar qasje ne dokumentat e OE te shpallur si fitues nuk qendrojne , pasi qe ky OE ne Aneksin 3 te Kerkesa per sekret afarist , duke permbushur kerkesat e dosjes se tenderit nen Nr, e prokurimit te sipercekur,paragrafi



**REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVO**  
**KUVENDI I KOMUNES - SKUPŠTINA OPŠTINE**  
**DRAGASH - DRAGAŠ**  
**ZYRA PËR PROKURIM – KANCELARIJA ZA JAVNU NABAVKU**

8 dhe 9 te informacionit per tenderuesit,ka derguar informacionet sekrete afariste si kontratat,referencat,çertifikatat,qarkullimi bankar dhe autorizimin e prodhuesit te cilat edhe ne si AK jemi te obliguar sipas LPP te i respektojme. Kjo eshte parapar sipas LPP ne nenin 11 (informatat sekrete afariste) dhe gjithashtu ne perputhje edhe me nenin **68** dhe **69** te ketij Ligji. Prandaj pretendimi juaj ne kete pike nuk qendron.

Se dyti nuk qendrojne aspak dyshimet tuaja se ne e kemi shperblyer OE i cili nuk i ploteson kriteret e kerkuar ne dosjen e tenderit dhe se e njeta nuk permbush kriteret si: referenca,kontrata,çertifikatat dhe autorizimin e prodhuesit. Te gjitha keto kriteret i permbush dhe vlersimi i ofertave eshte bere konforme kerkesave dhe dosjes se tenderit dhe fitues eshte shpallur OE i pergjegjeshem me çmimin me te lire. Prandaj edhe ky konstatim i juaji nuk qendron.

Ne fund vendoset si ne dispozitiv te ketij vendimi.

**Keshilla juridike:** Pala e pa kenaqur sipas nenit 109 te ketij Ligji,mund te ankohet ne Organin Shyrtues te Prokurimit Publik te Kosoves ne afat prej 10 ditesh,nga marrja e ketij vendimi .

**Dragash 15.04.2021**

**zyrtari pergjegjes per prokurim**

**Nuro Ismaili**